

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIKE DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

**DALLIMI NDËRMJET NXËNËSVE DHE NXËNËSEVE NË STILIN E
JETESËS**

Mentori:
Prof. Dr. Bujar Turjaka

Kandidatet:
Rita Elezi
Venesa Aliu

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. HULUMTIMET E DERITANISHME	9
3. QËLLIMI I PUNIMIT	13
4. HIPOTEZAT THEMELORE	14
5. METODAT E HULUMTIMIT	15
5.1 MOSTRA E TË ANKETUARVE	15
5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE	16
5.2.1 PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS	16
5.3 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	17
6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE	
6.1 FREKUENCA E GRUPEVE, NXËNËSVE NGA QYTETI, NXËNËSEVE NGA QYTETI, NXËNËSVE NGA FSHATI DHE NXËNËSEVE NGA FSHATI.....	18
6.2 DALLIMI NË MES GRUPEVE, NXËNËSVE NGA QYTETI, NXËNËSEVE NGA QYTETI, NXËNËSVE NGA FSHATI DHE NXËNËSEVE NGA FSHATI.....	30
6.3 PARAMETRAT THEMELOR STATISTIKOR.....	42
6.4 DALLIMI NË MES MESATAREVE ARITMETIKORE TË GRUPEVE SIPAS POST-HOC ANALIZËS	46
6.5 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	50
7. PËRFUNDIMI	51
8. RËNDËSIA E PUNIMIT	53
9. LITERATURA	54

1. HYRJE

Aktivitetet fizike rekreative të rregullta duhet të jenë pjesë përbërëse e mënyrës aktive jetësore. Në aktivitetin e përditshëm të lirë zakonisht përdoren: ushtrimet e mëngjesit, ecje, vrapim i lehtë, vozitje me biçikletë, notim dhe aktivitete të tjera në afërsi të banesës. Numër i vogël i popullates (rreth 10%) i nënshtrohet aktiviteteve që përveç aspektit më të mirë shëndetësor mund të sigurojnë një gjendje fizike të mirë. Njerëzit nuk vendosin që të fillojnë ose të heqin dorë nga programi i ushtrimeve, pasi nuk iu është shpjeguar në mënyrën e duhur kuptimi i aktivitetit, dhe zgjedhja e aktiviteteve të veta bazohet në numrin e të rrahurave të zemrës në minuta dhe në parametra të tjerë të rrepta mjekësore, e jo në dëshirën apo ndjenjën e suksesit. Njerëzit aktiv janë më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm, kanë një qëndrim më pozitiv ndaj punës dhe më mirë ballafaqohen me stresin e përditshëm. Personat aktiv të moshuar janë më të lumtur në jetë, më pak të varur nga të tjerët dhe më të shëndetshëm. Marrur individualisht, mungesa e aktiviteteve fizike dhe rritja e konsumimit të ushqimit të lartë duhet të jetë një problem i madh, megjithatë, nëse shikoni në mënyrë globale, veçanërisht në disa vitet e fundit, shihet se ekziston rritja alarmante e numrit të sëmundjeve që lidhen me këtë mënyrë jetese. Personat aktiv, jo vetëm që përmirësojnë gjendjen e tyre shëndetësore dhe fizike, por edhe që është më e rëndësishmja, janë të mbushur me ndjenjën e kënaqësisë dhe fuqisë së brendshme, gjë që pasqyrohet pozitivisht në të gjitha fushat e jetës së tyre. Çdo person duhet të merret me aktivitete fizike të intensitetit të mesem gati çdo ditë 30 deri në 60 minuta.

Çdo shkencë apo lëmi ka përkufizimin e vet po ashtu edhe rekreacioni ka përkufizimin e vet. Fjala rekreacion rrjedh nga fjala rec reo are, që do të thotë: ripërtëritje, rikrijim, formim, përsëritje, argëtim, etj. Rekreacioni sportiv sot për ripërtëritjen përdoren disa terma si; ripërtëritja sportive, ripërtëritja fizike, ripërtëritja trupore, ripërtëritja ushtrimore-fizike, lëvizjet ripërtëritëse, ripërtëritja turistike, ripërtëritja shëndetësore, ripërtëritja kineziologjike, ose vetëm ripërtëritje në gjuhën shqipe në vend të rekreacionit. Ripërtëritja është nevojë e shoqërisë, për arsye se njeriu ndjen nevojë për veprimtari (lëvizje) e cila ndikon drejtpërdrejt në organizmin e njeriut dhe freskinë e tij në mënyre pozitive. Ripërtëritja, përfshin dhe angazhon të gjithë ata që ndjenjë nevojë për lëvizje, veprimtari dhe ushtrim të trupit, pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësitë psiko-lëvizore etj. Veprimtaria e ripërtëritjes është organizim që merren fëmijët e moshës parashkollore, shkollore, të rinjtë, moshë mesatare, e vjetër e deri te punëtorët në organizatat punuese që merren me veprimtari ripërtëritëse-sportive. Pra, të gjithë merren me ripërtëritje.

Qëllimi i ripërtëritjes është t'i ndihmojë njeriut t'ia lehtësojë vështirësitë që i ofron mënyra bashkëkohore e jetës dhe punës dhe të korrigjojë ndikimet negative të aftësive trupore dhe shpirtërore, pastaj t'ia ofrojë të gjitha ato (kënaqësinë, relaksim, freskimin) që ia merr mënyra jetës dhe punës, duke mos shfrytëzuar racionalitetin. Pra, thelbësorja është që ripërtëritja të ndikojë në mbajtjen e aftësive trupore dhe shpirtërore në nivel.

Marrja me ripërtëritje sportive të njeriut motivon edhe në përmirësimin e marrëdhënieve mes njerëzve dhe jep motivin për veprimtarinë e tij të përditshme. Rekreacioni sportiv Ripërtëritja si proces i organizimit shoqëror dhe si fenomen përfshin veprimtarinë jashtë procesit të punës. Qëllimi i kësaj veprimtarie është që të freskojë njeriun, t'ia ofrojë kënaqësi, t'ia kontribuojë në zhvillimin e aftësive si dhe t'ia përmirësojë vlerat e të mbrojë shëndetin në tërësi në mënyrë që të ndikojë në aftësitë e tij. Ripërtëritja me të gjitha funksionet dhe lojërat e veta ka për qëllim ta krijojë një shoqëri të shëndoshë e me zbavitje, e cila së bashku me freskinë i sjellin njeriut kënaqësinë e kërkuar.

Ripërtëritja sportive ka qëllim edhe korrigjimin e monotonisë në kthim të jetës freskuese, lëvizore, të kënaqjes, largimin nga anët negative, e që me këtë ndikojnë edhe në rritjen e aftësive motorike-lëvizore, funksionale të organizimit të njeriut. Po ashtu, marrja me ripërtëritje sportive, zvogëlon deri në minimum lodhjen, monotoninë, lëndimet e disa dukuri të tjera. Në Përmbytja e veprimtarive me të cilat merren sot popullatat dhe format e ripërtëritjes mund të jenë të shumta dhe për këtë arsye ripërtëritjen mund ta sistemojmë në këto llojet: ripërtëritja në kulturë dhe teknikë, ripërtëritja shoqërore-zbavitëse, ripërtëritja sipas dëshirave, ripërtëritja e sportit (për të cilin edhe do të flitet).

Për një jetë më të mirë, më cilësore dhe një prej kushteve më të rëndësishme për shëndet të mirë është pa dyshim lëvizja. Kryesorja për zhvillimin e personalitetit të përgjithshëm (guximin, përkushtimin, përkatësin grupore, shoqërizimin). Aktiviteti fizik i thjeshtë do të thotë çdo lëvizje e trupit që lëviz muskujt tuaj dhe kërkon më shumë energji se sa gjatë pushimit. Ecje, vrapim, vallëzim, puna fizike, not, yoga dhe kopshtari janë disa nga shembujt e aktivitetit fizik (Abernethy, 2005)

Njerëzit të cilët bëjnë një jetë të shëndetshme dhe që rregullisht përfshihen në ushtrime, kanë më pak mundësi të zhvillojnë sëmundje kronike, duke përmendur këtu diabetin jo insulin-vartës, sëmundjet kardio-vaskulare, sëmundjet tumorale ose sëmundjet mendore. Gjithashtu aktivitete fizike rekreative kontrollojnë peshën trupore, sigurojnë lëvizshmëri më të mirë të

nyjeve, rrisin forcën e eshtrave, zvogëlojnë rrezikun nga paraqitja e osteoporozës, përmirësojnë ekuilibrin dhe koordinimin, përmirësojnë frymëmarrjen, përmirësim të gjumit, vlerave energjetike etj. Pjesëmarrja në aktivitete rekreative përmirëson mirëqenien fizike. Në fakt, njerëzit që shpesh merren me aktivitete rekreative kanë më pak vizita mjekësore dhe indeks in e masës trupore më të ulët të (BMI) sesa ata që nuk bëjnë. Ne besojmë se sporti dhe rekreacioni mund të jenë një mjet i rëndësishëm për ndryshime pozitive në shoqëri (Beedie и cop., 2000).

Nëse e shikojm njeriun e ditëve të sotme, e shikojm nga pozicioni i njeriut modern sedentar (homo sedens), të cilin e karakterizon mungesa e lëvizjeve (hipokinezia), dieta e tepërt dhe stresi, mund të thuhet se lëvizjet e karakterit ciklik aerob, sporti dhe aktivitetet kineziologjike imponohen si nevojë reale (Warburton и cop., 2006). Nuk ka dyshim se hipokinezia në fëmijëri dëmton rritjen dhe zhvillimin biologjik, në moshën madhore dëmton shëndetin, ndërsa pasiviteti në moshë të vjetër është më shpesh fatal (Gallahue и Donnelly 2003).

Shikuar hulumtimet që analizojnë efektet e aktiviteteve aerobe në shëndetin e njeriut, hasim në dëshmi të shumta për ndikimin pozitiv të lëvizjes në shëndet dhe në cilësinë e jetës. Studime të shumta kanë konfirmuar ndikimet pozitiv të ushtrimeve fizike të tipit ciklik në sëmundjet respiratore (astma), diabetit, deformimet individuale të kockave dhe mbipesha (Brown и cop., 2007; Di loreto и cop., 2005; Mustelin и cop., 2009; Warbourton и cop., 2001; Kruk, 2007; Larson и cop., 2006).

Aktiviteti fizik është një nevojë natyrore e çdo qenie njerëzore dhe është definuar si çdo lëvizje e sistemit muskolor dhe skeletit që rezulton në hargjimin e energjisë mbi nivelin që trupi hargjon në pushim (Melzer et al. 2004). Nga një numër i madh studimesh mund të shohim se aktiviteti fizik ka një ndikim të ndjeshëm në uljen e shfaqjes së sëmundjeve kardiovaskulare, fillimin e diabetit 2, osteoporozës, artritet dhe dhimbjeve të shpinës (Melzer et al., 2004), madje ndikon edhe në zvogëlimin e disa lloji i tumorit (Mišigoj – Duraković и cop., 2006; Duraković и cop., 2006), dhe si i tillë ka një ndikim të madh në jetën e njeriut.

Aktiviteti fizik gjithashtu ka një ndikim të madh në uljen e mbipeshes, dhe ne e konsiderojmë atë mënyrën më të natyrshme të hargjimit të energjisë dhe rregullatorin e peshës. Për kë te disa autorë (Hill dhe Wyatt, 2005) argumentojnë se aktiviteti fizik mban një ekuilibër të energjisë në trup, duke parandaluar kështu shfaqjen e peshës së tepërt.

Ka disa arsye që shkaktojnë mbipeshën. Një ndër to mund të jetë për shkak të çrregullimeve të caktuara hormonale apo çrregullimeve metabolike. Megjithatë, para së gjithash,

mbipesha ndodh si rezultat i mungesës së aktivitetit fizik dhe diete të parregullt (Melzer *и cop.*, 2004). Domethënë, nëse në organizëm rregullt merren më shumë kalori se mund të harxhojmë, kaloritë e tilla të marra nga ushqimi do të konvertohet në peshë të tepërt në formën e yndyrës së depozituara. Shumica e njerëzve, për ti u larguar mbipeshës, iu nënshtrohen një dietave rraskapitëse (urisë), e cila në të shumtën e rasteve përcillet me pasoja të shumta shëndetësore (Hackney, 2006).

Duke përmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme (aerobike) me trajnime, rritet madhësia dhe numri i mitokondrive dhe përqendrimi i enzimave oksiduese brenda qelizave të muskujve, të cilat rrisin aftësinë e organizmit për të përdorur sasi më të mëdha të yndyrës gjatë aktivitetit fizik (Martin *и cop.*, 1993).

Nga fillimet e hulumtimit për efektet e aktivitetit të rregullt fizik dhe ushtrimit në parandalimin e aterosklerozës dhe zhvillimin e sëmundjes koronare të zemrës, janë raportuar efekte të rëndësishme të ushtrimit në nivelin e yndyrës së gjakut, mbi të gjitha, në rritjen e nivelit të kolesterolit HDL, në zvogëlimin e kolesterolit LDL në raport me HDL-kolesterolin dhe një rënie të niveleve të triglicerideve në gjak.

Pas përcjelljes shumëvjeçare të lipidogramit të një grupi të meshkujve të përfshirë në një program të ushtrimeve (mesatarisht 3.5 ditë në javë) midis moshës 30 dhe 51 vjeç, treguan një përmirësim të ndjeshëm në përqendrimin e kolesterolit HDL, kolesterolit LDL, triglicerideve dhe kolesterolit total (Teramoto dhe Golding, 2009)

Disa hulumtime tregojn se aktivitet me vrapimin 12 milje në javë me intenzitet të mesëm sjellin deri tek ndryshimet në nivelin e lipideve në gjak, ndërsa një aktivitet i barabartë me vrapimin 20 milje në javë rrit ndjeshëm nivelin e kolesterolit HDL. Në krahasim me grupin e kontrollues e cila nuk ka aplikue program të ushtrimeve, në grupin që ishin përfshirë në programin e aktivitetit fizik është vërejtur ulje e vlerave

Shumica e studimeve të hershme transversale bazuar në krahasimet në mes atletëve të cilët kanë realizuar programin me ushtrime të qëndrueshmërisë aerobike dhe individëve joaktivë, rezultatet kanë treguar nivele më të ulëta të triglicerideve tek atletët (Cooper *и cop.*, 1976). Rezultatet u konfirmuan te shumë studime eksperimentale në të cilat subjektet iu nënshtroan programeve të trajnimit aerobik disa muajshe (Gyntelberg *и cop.*, 1977). Shkalla e ndryshimeve në nivelet e triglicerideve në gjak të raportuara në studime nga autorë të ndryshëm ndryshonte me vëllimin e procesit të trajnimit dhe vlerat fillestare të triglicerideve në gjak.

Ushtrimi / stërvitja e rregullt (që përfshin përveç aktivitetit aerobik edhe stërvitje të moderuar të qëndrueshmërisë) kontribuon në ngritjen e gatishmërisë funksionale të trupit për të përballuar ngarkesën. Kjo e bën të mundur rritjen graduale të shpeshtësinë e ushtrimit, kohëzgjatjen dhe intensitetin e ushtrimit dhe siguron mundësi e një rritje graduale të vëllimit të ushtrimeve dhe kështu rrit shpenzimin e përgjithshëm të energjisë - përcaktuesit kryesorë të ndikimit të ushtrimit në zvogëlimin e nivelit të triglicerideve në gjak (Hardman, 2007). Stërvitja me intensitet me 80-90% ka një efekt akut më të madh në uljen e nivelit të triglicerideve të gjakut te individit i trajnuar (përshtatur nga trajnimi i rregullt i qëndrueshmërisë me intensitet të lartë) në krahasim me personin e pa trajnuar. Kjo për faktin se një person i trajnuar me të njëjtin intensitet relativ do të ketë një shpenzim të konsiderueshëm më të lartë të energjisë duke pasur parasysh aftësitë e tyre më të mëdha funksionale në krahasim me personin e pa trajnuar (Hardman, 2007).

Aktiviteti fizik ka efektin e zvogëlimit të yndyrës nënëkuror dhe përshpejtimin e metabolizmit, dhe ka një efekt domethënës në sistemin hormonal, i cili nga ana e tij parandalon shfaqjen e kilogramëve të tepërt (Hackney, 2006) dhe gjithashtu ka efektin e zvogëlimit të shfaqjes së çdo çrregullimi psikiatrik në lidhje me pakënaqësinë për pamjen fizike të një personi.

Aktivitetet e ndryshme fizike dhe sportive luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit fizik, kondicional dhe mental tek fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën e adoleshencës së vonshme tek dy gjinitë, domethënë ndikon në zhvillimin normal të tyre. Fëmijët dhe të rinjtë janë të etur për të mësuar aktivitete të ndryshme sportive dhe ata janë të lumtur t'i provojnë ato. Për sa kohë që ata mbajnë kontrollin e gjendjes kondicionale të lartë ata ndjehen të sigurt se janë të suksesshëm. Ata nuk kanë nevojë për arsye të ndikimit nga rrethi social për të luajtur dhe zhvilluar aftësitë e tyre. Sepse fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën e vonshme të adoleshencës kanë motivin për këtë.

Prandaj, kur organizohen aktivitete sportive për fëmijë dhe të rinjtë, duhet të krijohen ambiente të përshtatshme në të cilat ata mund të mësojnë aftësi fizike, të ngrisin nivelin kondicional dhe vetbesimin, dhe sigurisht nuk duhet të jenë të vështira për performancën sportive të tyre. Qëllimi nuk është të krijohet një ndjenjë dështimi, por një ndjenjë suksesi. E gjitha këto aktivitete fizike dhe sportive duhet të shoqërohen me ngritjen e nivelit shëndetësor, rritjen e vetbesimit për të patur sukses për një performance sa më të mirë në lojë dhe zhvillimin e tyre shoqëror (Öztürk, 1988).

Në dhjetë vitet e fundit, shumë sondazhe mbi këtë temë janë përpjekur të përcaktojnë se çfarë është më efektive në trajtimin e depresionit. Mendohet se nevojitet më shumë aktivitete aerobe gjatë javës me ushtrime më intensive për të përmirësuar gjendjen shpirtërore. Efekti antidepressiv ndodh shumë shpejt, do të thuhet menjëherë pas ditëve të para të stërvitjes. Sidoqoftë, efekti i vërtetë arrihet vetëm pas 4 deri në 9 javëve.

Rekomandohen të ashtuquajturat ushtrime aerobike si vrapim, not, çiklizëm, ecje dhe të ngjashme. Në krahasim me ushtrimet relaksuese, aktivitetet sportive në depresion raportohet se janë edhe më të mira. Aktiviteti fizik, pavarësisht nga mosha dhe gjinia, luan një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e mbipeshes. Pavarësisht nga mosha dhe mbipesha, aktiviteti fizik i kontrolluar në mënyrë sistematike kontribuon në ruajtjen e gjendjes optimale shëndetësore. Është shumë e rëndësishme të krijohet një shprehje për të aplikuar ushtrime fizike në moshë deri 20 vjeçare në mënyrë që më vonë ai të bëhet një mënyrë e jetës, dhe kështu të ndikojë në cilësinë e jetës.

Aktivitetit fizik sportiv i pamjaftueshëm është një problem i madh për shëndetin e një kombi, dhe është argumentuar se ky është një faktor që kontribuon në zhvillimin e sëmundjeve të shumta kronike dhe çrregullime të shumta shëndetësore (Blair, La Monte & Nichaman, 2004). Interesimi për të marrur me aktivitete fizike si dhe për ngritjen e aftësive motorike të njerëzimit sedentar në vitet e fundit është gjithnjë e duke u bërë objekt i kërkimeve shkencore. Egzistojnë arsye të shumta për kërkime shkencore të aftësive psikofizike të njeriut si vërtetimi i efekteve të programeve të caktuara stërvitore, verifikimi i programit stërvitor, përcaktimin e parametrave të caktuar për vlerësimin e aftësive initiale, si një bazë për ndërtimin dhe zbatimin e ushtrimeve në të ardhmen dhe kështu me radhë.

Nga pika e kibernetikës dihet se trupi i njeriut shikohet si një sistem kompleks, vetërregullues dhe dinamik. Kompleks sepse përbëhet nga disa nënsisteme të lidhura (kardiovaskulare, të frymëmarrjes, nervor, etj). Sistem vetërregullues sepse mund të gjejë një mënyrë të pavarur regjimit më optimal të aktivitetit jetësor gjatë ndryshimit të kushteve të jashtme ose të brendshme. Dinamik është për shkak se ajo mund të ndryshojë gjendjen e e vet nën ndikimin e faktorëve të tjerë të jashtëm.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Në hulumtimin dhe studimin e literaturës që kemi pasur në dispozicion, në mes tjerash duhet të përmendim këto hulumtime:

Burton dhe Turrell (Burton & Turrell, 2000) në Australi kanë hulumtuar marrëdhënien e profesionit, kohën e kaluar në punë dhe aktivitetin fizik në kohën e lirë te personat e moshës së mesme në një mostër prej 21,787 personave të anketuar. Rezultatet treguan se 67.7% e të anketuarve nuk ishin mjaft aktivë (gratë ishin jo aktive (72.2%) sesa meshkujt (64.8%). Në mesin e meshkujve që më së paku kanë qenë të përfshirë në aktivitet fizik, kanë qenë ata që kanë fëmijë, që janë duhanpirës dhe me status shëndetësor të dobë.

Okano me bashkëpunëtorë (Okano, Miyake, & Mori, 2003) hulumtuan marrëdhënien midis punonjësve të grupmoshës së moshës së mesme (nga 50 deri 59 vjeç, të punësuar në një kompani e madhe në Hokkaido) dhe aktivitetin e tyre fizik në kohën e lirë, dhe shëndeti i të cilëve është vlerësuar subjektivisht. Në bazë të rezultateve të marra është evidente se vlerësimi subjektiv i shëndetit është i lidhur me aktivitetin fizik në punë, aktiviteti fizik në kohën e lirë dhe stresin psikologjik.

Leino-Arjas dhe bashkëpunëtorë (Leino-Arjas, Solovieva, Riihimaki, Kirjonen, & Telama, 2004) kanë hulumtuar lidhjen ndërmjet ngarkesës në vendin e punës dhe aktivitetit fizik në kohën e lireme vlerësimin subjektiv të shëndetit fizik. Rezultatet e arritura treguan se aktiviteti fizik intensiv zvogëlon mundësinë e çregullimit të nivelit të shëndetit fizik, kryesisht në fazat e mëvonshme të jetës.

Ali & Lindstrom, (2006) në hulumtimin e tyre kushtet janë marrur me kushtet psiko-sociale në punë, aktivitetet fizike në kohën e lirë, dhe me të papunët në Suedi. Rezultatet treguan se meshkujt, krahasuar me femrat më pak të angazhuar në aktivitete fizike në kohën e tyre të lirë.

Kouvonen dhe bashkëpunëtorë (Kouvonen, et al., 2005) hulumtuan lidhjen midis aktivitetit fizik në kohën e lirë dhe punën dhe ngarkesën në punë te femrat dhe meshkujt e punësuar në sektorin public. Rezultatet e fituara tregojnë se niveli i aktivitetit fizik në kohën e lirë dukshëm zvogëlohet me rritjen e moshës dhe rënien e statusit socio-ekonomik.

Schneider dhe Becker (Schneider & Becker, 2005) kanë hulumtuar se sa aktivitet fizik ka popullsia e moshës së mesme (të punësuar) në Gjermani. Qëllimi ishte identifikimi i përfshirjes së punonjësve në aktivitete fizike dhe përcaktimi i faktorëve që lidhen me punën që

ndikojnë në pjesëmarrjen në aktivitete sportive. Rezultatet e fituara tregojnë se 39.2% e popullsisë nuk marrin pjesë në sporte, 19% ushtrojnë të paktën 1 orë në javë, 20.2% ushtrojnë rregullisht 1-2 orë në javë, 13.4% e pjesëmarrësve ushtrojnë 2-4 orë në javë.

Proper me Bashkëpunëtorë (Proper, et al., 2003) studiuuan në hulumtimin e tyre efektivitetin e programeve të aktivitetit fizik gjatë orarit të punës në nivelin e aftësive fizike dhe shëndetit. Rezultatet tregojnë se stërvitja fizike gjatë orarit të punës është me rëndësi të madhe në parandalimin e rrezikut të çrregullimeve muskulo-skeletore.

Thogersen-Ntoumani dhe Fox (Thogersen-Ntoumani & Fox, 2005) kanë kryer një sondazh për të identifikuar punonjësit në bazë të aktivitetit fizik, indeksit të masës trupore, variablave demografike dhe shëndetit mendor. Rezultatet tregojnë se mungesa e ushtrimit fizik dhe mungesa e vetëbesimit lidhen me kënaqësinë e punës.

Huskovci & Beqiraj (2013) theksijn se aktivitetet fizike si dhe fitnesi përfshin një seri të procedurave të aktiviteteve të programuara fizike me të cilën përmirësojmë gjendjen e përgjithshme dhe aftësitë fizike të trupit. Fitnesi është një term që i referohet një gjendje të mirë fizike dhe mendore, gjendjen e mirë shëndetësore fizike që rezultonë nga ushtrimi i rregullt fizik dhe të ushqyerit e duhur, si dhe aftësinë për të kryer çdo lloj të aktiviteteve profesionale dhe të përditshme pa ndjenjë tendosje. Shkalla e lartë e shëndetit kontribuon në cilësinë e jetës në përgjithësi, si dhe luftën e suksesshme kundër stresit. Aktivitetet e përditshme, të rregullta dhe të vazhdueshme kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit tonë dhe pamjes fizike, dhe të na bëjë të aftë. Ndarja më e plotë dhe më e kuptimt e fitnesit është propozuar sipas disa autorve të cilët e ndajnë: a) Fitnesin Fiziologjik, b) Fitnesin e Lidhur me Shëndetin, c) Fitnesin e Lidhur me aftësitë, d) Fitnesin e Lidhur me sportin. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të vërtetohet fakti se sa është ngritur vetëdija e popullatës së Komunës së Gjilanit dhe Kamenicës për tu kyçur në aktivitetet fizike, koonkretisht për tu marrur me fitnes. Për realizimin e këtij qëllimi janë parashtruar tri hipoteza. Popullata nga e cila është nxjerrur mostra e entitetit është definuar si popullatë e personave nga komuna e Gjilanit dhe e Kamenicës, që ushtrojnë fitnes në salla të fitnesit së paku mbi 6 muaj. Popullata ka përfshirë 65 femra dhe 88 meshkuj nga Komuna e Gjilanit dhe 42 femra dhe 67 meshkuj nga Komuna e Kamenices. Për realizimin e këtij punim janë aplikuar disa variabla në form të pyetsorit të cilat janë plotsuar nga personat që janë anëtar i ndonjë klubi të fitnesit së paku 6 muaj fitneset nga komuna e Gjilanit dhe e Kamenicës. Pyetsori ka përfshirë gjithsej 12 pyetje. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se interesimi më i madh

për tu marr me fitnes është nga mosha 18-29 vjeçare. Ajo çka është me rëndësi të theksohet se interesimi për tu marr me fites është kryesisht për qëllime të dukjes sa më të mirë fizike.

Nešić me bashkëpunëtorët (2014), në një mostër prej 450 femra të moshës mesatare nga zona e bashkësisë më të ngushtë të qytetit të Novi Sadit, kanë pasur për qëllim identifikimin e disa faktorëve të marrëdhënieve ndërmjet jetesës së perceptuar dhe përmbajtjes së ushtrimeve sportive-rekreative. Ata arritën në përfundimin se qëndrimi i të anketuarve ndaj ushtrimeve fizike (rekreacionit) i referohet mosnjohjes së ushtrimeve fizike të rregullta si një segment i rëndësishëm i jetës së përditshme tekjo popullatë femër e vjetër. Kështu, shumica e subjektit hulumtues deklaruan se ata kalojnë pasivisht kohën e lirë, respektivisht rrallë (ose vetëm herë pas here) praktikojnë një formë të ushtrimeve rekreative. Më pak se 20% të tyre e ushtrojnë rregullisht (të paktën tri herë në javë), ku përkatësia e një grup moshë të caktuar ka dëshmuar të jetë një faktor i rëndësishëm (dallimet dhe niveli i rëndësisë statistikore).

Selmanaj & Ermira (2017) theksojnë se rinia e moshës 16-17 vjeçare e tri qyteteve të Kosovës nuk janë të rrezikuara nga tendenca e theksuar e mbipeshës për shkak të joaktivitetit. Dallimet të cilat egzistojnë në nivel të përfshirë në aktivitete rekreative-sportive janë të theksuara në mes të femrave dhe meshkujve të kësaj moshe. Meshkujt janë dukshëm më shumë të përfshirë në aktivitetet rekreative dhe në klube sportive. Shprehjet pozitive që ndërlidhen me aktivitetin fizik, aktivitetet rekreative janë më të theksuara te gjinia e meshkujve se te e femrav. Dallimet në përfshirje në aktivitete rekreative - sportive si dhe në shprehjet të ndryshme të jetuarit nuk janë të theksuara në bazë të përkatsis së të rinjëve qytetevë të ndryshme të Kosovës.

Sinani (2018) – thekson se vertetur se rezultatet e fituara rezultojnë me një përqindje më të madhe të marrjes me aktivitete rekreative sportive tek femrat e grup moshave 17-18 vjeçare se sa tek meshkujt e po të njëjtes moshe. Dallimet janë vertetur edhe rreth konsumit të alkoolit. Eshtë vertetur se djemte e moshës 15-16 vjeq konsumojnë më tepër alkool se sa femrat e po të njëjtes moshe sikur edhe me shume se sa meshkujt e moshës 17-18 vjeçare. Dallimet janë vertetur edhe në atë se sa ore gjumi bëjnë. Ku është vertetur se meshkujt e moshës 17-18 vjeçare kalojnë me shume ore gjume gjate ditës se sa meshkujt e moshës 15-16 vjeçare. Dallimet janë vertetur edhe lidhur me preferencën e tyre për t'u marrë me sport po të kishit mundësi ku është vertetur se femrat e moshës 15-16 vjeçare janë më pak të predispozuar sesa femrat e moshës 17-18 vjeçare për t'u marrë me aktivitete sportive po të kishin mundësi.

Kaçiu & Daci (2018) në punimin e tyre theksojnë se aktiviteti fizik si një nga komponentët thelbësore të një jetese të shëndetshme, përfaqëson të gjitha lëvizjet që rrisin harxhimin e energjisë, e cila është më e lart se sa ai harxhim i energjisë tek njerëzit që nuk zhvillojnë aktivitete fizike (pushojnë). Me këtë lloj aktiviteti kryesisht përfshihen aktivitetet e përditshme (ecjet në këmbë, çiklizëm, ngjitje shkallëve, punë në shtëpi, duke shkuar për të blerë, etj). Ky studim ka pasur për qëllim të hulumtoj efektet e stilit të jeteses dhe aktiviteteve fizike rekreative në indeksin e masës trupore (BMI) te rinia e shkollave të mesme të lartë. Mostra për këtë punim është definuar si nxënës të moshës 16-17 vjeçare të shkollave të mesme (Podujevë dhe Pejë). Mostra në këtë punim ka përfshirë 400 nxënës, të anketuar të dy komunave të Kosovës nga 200 nxënës të secilës komunitet të dyja gjinive. Grupin e të anketuarve e kanë përbërë nxënësit e kalsëve të njëmbëdhjeta (XI), nga 100 femra dhe 100 meshkuj të secilës komunë. Si instrument i hulumtimit është përdorur pyetëtori, i modifikuar dhe riformuluar për këtë hulumtim. Një grup i pyetjeve ka siguruar të dhëna rreth pjesëmarrjes në aktivitete dhe llojin e tyre, ndërsa grupi tjetër i pyetjeve ka të bëjë në vlerësimin e shprehive të jetesës të të anketuarve si indikator ose tregues kryesor janë të dhëna dhe përshkrimet e aktiviteteve të mëposhtme të cilat konsiderohen si shprehje të jetesës: Pirja e cigareve, konsumimi i alkoolit, ushqimi i rregullt, gjumi i rregullt dhe marrja me aktivitete rekreative – sportive si dhe shprehjet e jetesës. Pyetëtori është i bashkëngjitur në shtojcë. Po ashtu si variabla janë përfshirë edhe lartësia e trupit dhe masa e trupit përmes të cilave është përcaktuar Indeksi i Masës Trupore (BMI). Rezultatet e fituara tregojnë se Indeksi i Masës Trupore (BMI) në këtë hulumtim nuk varet nga aktivitetet rekreative sportive dhe shprehjet e jetesës por nga energjitë e konsumuara dhe kohëzgjatja e aktiviteteve rekreative sportive.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimet e aktiviteteve fizike rekreative janë:

a) Qëllimet biologjiko – shëndetësore (higjienike)

Çështja e procesit të aktivitetit fizik rekreativ sipas moshave (grupmoshave) është problem i madh , sidomos kur është në pyetje arritja dhe realizimi i detyrave biologjiko-shëndetësore (higjienike), që janë të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin dhe aftësimin shëndetësor të tyre dhe ate: 1. zhvillimi i gjithanshëm i organeve të organizmit të njeriut, 2. formimi dhe ruajtja e shëndetit të njeriut, 3. formimi dhe ruajtja e të mbajturit të drejtë të trupit, 4. përmirësimi i funksioneve fiziologjike të sistemeve të ndryshme, 5. formimi i imunitetit të organizmit ndaj sëmundjeve dhe “çelikosja “, 6. sigurimi i pushimit aktiv dhe përvetësimi i shprehive higjienike (pastrimi , veshëmbathja , ushqimi , gjumi etj.) .

b. Qëllimet pedagogjike - Qëllimet arsimore

Aktiviteti fizik rekreativ, me përmbajtjet programore të përmbledhura në bazë të moshës, gjinisë, aftësive psikomotorike në aspektin arsimor ka për detyrë: 1. zhvillimin e lëvizjeve koordinuese, 2. formimin e shprehive motorike, 3. perfeksionimin e shprehive motorike , 4. zhvillimin e aktiviteteve krijuese dhe sigurimin e diturive teorike zhvillimin e forcës, shpejtësisë, qëndrueshmërisë, lëvizshmërisë, precizitetit.

c. Qëllimet edukative

Edukimi dhe krijimi i mardhënies pozitive ndaj punës, krijimi i disiplinës dhe punës së vetëdijshme, krijimi i marrëdhënies pozitive ndaj shëndetit, humanizimi, shoqërimi etj: zhvillimi i aftësisë për edukim estetik (shijimi i të bukurës), 2. zhvillimi i vullnetit dhe i qëndrimit të drejtë ndaj punës dhe 3. sigurimi i aktiviteteve argëtuese – zbavitëse dhe pushimit aktiv.

Qëllimi i këtij punimi është që të vërtetoj dallimi ndërmjet nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale si dhe nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale në pyetjen Frekuentoni qendrat rekreative sportive-fitnesset dhe Mereni me sport aktivisht, si dhe në disa pyetje të stilit të jeteses.

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Qëllimi i këtij punimi është që të vërtetohet dallimi ndërmjet nxënësve dhe nxënësve si dhe nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale në angazhimin e tyre në aktivitetet rekreative sportive.

Duke u mbështetur në qëllimin e këtij punimi janë parashtruar këto hipoteza:

Hipoteza H1. Ndërmjet nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në pyetjen, “Mereni me sport aktivisht”.

Hipoteza H2. Ndërmjet nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në pyetjen, Mereni me sport aktivisht.

Hipoteza H3. Ndërmjet nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në pyetjen, “Mereni me sport aktivisht”.

Hipoteza H4. Ndërmjet nxënësve nga viset urbane dhe nxënësve nga viset rurale ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në pyetjen, “Frekuentorni qendrat rekreative sportive-fitnesset”.

5. METODAT E HULUMTIMIT

5.1 MOSTRA E TË ANKETUARVE

Në këtë punim mostra është përbërë 200 nxënës maturant (100 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 100 nxënës të gjinisë femrore) respektivisht (50 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 50 nxënës të gjinisë femrore nga viset urabane dhe 50 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 50 nxënës të gjinisë femrore nga viset rurale) të shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit. Moshë e të anketuarve ka qenë nga 17 deri 18 vjeçe. Të anketuarit dhe anketuarat e përfshir në punim kanë pranuar vullnetarisht ti përgjigjen pyetësorit të parashtruar domethënë me dëshirë kanë pranuar të jenë pjesë e këtij hulumtimi.

5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

5.2.1 Pyetësi për stilin e jetesës

Për të marrë të dhëna në lidhje me stilin e jetës së nxënësve të gjinisë mashkullore dhe femrore është përdorur pyetësi që ka ofruar informacione të mjaftueshëm për qëllimet e këtij punimi. Pyetësi ishte anonim dhe përfshi gjithsej 14 pyetje (Ryan, Fredrick, Lepas, Rubio dhe Sheldon 1997) modifikuar sipas qëllimit të këtij punimi.

Pyetësi ka qenë anonim dhe përmbajtja e pyetjeve ka qenë si në vijim:

1. Gjinia: nxënës – nxënëse?
2. Vendbanimi: Fshat – Qytet?
3. Arsimimi i babait?
4. Arsimimi i nënës?
5. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të familjes?
6. Sa anëtarë të familjes janë në punë të përhershme?
7. Numri i anëtarëve të familjes që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit?
8. Sa anëtarë të familjes janë studentë?
9. Të ardhurat financiare mujore në familje?
10. Frekuentoni qendrat rekreative sportive-fitnesset
11. Mereni me sport aktivisht
12. Sa orë gjumë bëni
13. Sa orë në ditë shfrytëzoni internetin
14. Sa orë në ditë lexoni dhe bëni detyrat shkollore

5.3 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Për të marrë të dhëna në lidhje me stilin e jetës së nxënësve të gjinisë mashkullore dhe femrore është përdorur pyetësori që ka ofruar informacione të mjaftueshme për qëllimet e këtij punimi.

Metodat e përpunimit të rezultateve kryesisht aplikohen në harmoni me qëllimin e hulumtimit, hipotezat e parashtruara si dhe me numrin e pjesëmarrësve në hulumtim. Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, janë përdorur procedurat e duhura që janë të natyrës së atij problemi të dhënë. Nga hapësira statistikore komparative (krahasuese) për dy grupe e pavarura të mostra është përdorur procedura diskriminative, para se gjithash, analiza parashikuese (χ^2 -Hi- katror testi) i cili aplikohet për të shqyrtuar dallimin në mes të frekuencave të vërejtura dhe pritura ose teorike brenda grupit dhe në mes grupeve dhe gjinive.

T-test mund të llogaritet vetëm atëherë nëse të dhënat ose shënimet janë të renditura në bazë të shpërndarjes normale ose të paktën sipas një shpërndarje simetrike, ndërsa χ^2 -Hi- katror testi, mund ta aplikojmë edhe në qoftë se shpërndarja (distribucioni) i rezultateve në mënyrë të konsiderueshme është e ndryshme nga normalja. Pra, kur nuk mund ta përdorim të ashtuquajturën, statistikën parametrike, e cila kërkon një shpërndarje (distribucion) normal dhe të dhëna sasiore (shënime kuantitative), përdoret χ^2 -Hi- katror testi i cili i takon të ashtuquajturës. statistika joparametrike. Për analoizimin e raporteve ndërmjet mesatareve aritmetikore është aplikuar analiza univariante e variancës ANOVA dhe analiza multivariante teknika Post-hoc-LSD.

6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE


6.1 FREKUENCA E GRUPEVE, NXËNËSVE NGA QYTETI, NXËNËSEVE NGA QYTETI, NXËNËSVE NGA FSHATI DHE NXËNËSEVE NGA FSHATI

Rezultatet e fituara me ndihmën e instrumenteve hulumtuese janë të paraqitura në përqindje, tabela, grafikone dhe tekstualisht sipas renditjes së përpunimit të tyre. Së pari janë të paraqitura tabelat dhe grafikonet e rezultateve të anketuarave (femra), e pastaj të anketuarëve (meshkuj). Në tabelën 1 janë të paraqitur përgjigjet e meshkujve nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF) në pyetjen Arsimimi i babait? Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre baballarër janë me fakultete (N=33); Sig. <000, te nxënëset nga qyteti baballarër janë me fakultete (N=33); Sig. <000, (N=33); te nxënësit nga fshati baballarër janë me fakultete (N=27); Sig. <000 dhe te nxënëset nga fshati baballarër janë me fakultete (N=32); Sig. <000

Tabela 1. Pyetja: Arsimimi i babait? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
SHM	9	SHM	4	SHM	17	SHM	11
FAK	33	FAK	33	FAK	27	FAK	32
MAS	8	MAS	13	MAS	6	MAS	7
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 24.040a		Chi-Square 26.440a		Chi-Square 13.240a		Chi-Square 21.640a	
Df 2		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .001		Asymp. Sig. .000	

Grafikoni 1.




Në tabelën 2 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen arsimimi i nënes te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre nëna janë me fakultete (N=33); Sig. <000, te nxënëset nga qyteti nëna janë me fakultete (N=40); Sig. <000; te nxënësit nga fshati nëna janë me fakultete (N=25); Sig. <000 dhe te nxënëset nga fshati nëna janë me fakultete (N=21); Sig. <000.

Tabela 2. Pyetja: Arsimimi i nënes? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
SHM	4	SHM	2	SHM	23	SHM	26
FAK	33	FAK	40	FAK	25	FAK	21
MAS	13	MAS	8	MAS	2	MAS	3
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 26.440a		Chi-Square 50.080a		Chi-Square 19.480a		Chi-Square 17.560a	
Df 2		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000	

Grafikoni 2.




Në tabelën 3 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen Numri i përgjithshëm i anëtarëve të familjes? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre kanë 4 anëtarë janë (N=26); Sig. <000, te nxënëset nga qyteti shumica i kanë 5 anëtarë (N=19); Sig. <000; te nxënësit nga fshati shumica i kanë 4 anëtarë (N=25); Sig. <002 dhe te nxënëset nga qyteti shumica i kanë 5 anëtarë (N=16); Sig. <000.

Tabela 3. Pyetja: Numri i përgjithshëm i anëtarëve të familjes? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
3	2	3	5	3	3	3	2
4	26	4	17	4	18	4	15
5	18	5	19	5	15	5	16
6	4	6	7	6	10	6	10
		7	2	7	4	7	4
						8	3
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 31.600b		Chi-Square 22.800b		Chi-Square 17.400b		Chi-Square 23.200b	
Df 3		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .002		Asymp. Sig. .000	

Grafikoni 3.




Në tabelën 4 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen Sa anëtarë të familjes janë në punë të përhershme? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre nuk kanë një anëtar të punësuar (N=33); Sig. <000, te nxënëset nga qyteti që kanë dy anëtar të punësuar (N=31); Sig. >090; te nxënësit nga fshati që kanë dy anëtar të punësuar (N=25); Sig. <001 dhe te nxënëset nga qyteti që kanë dy anëtar të punësuar (N=22); Sig. <001.

Tabela 4. Pyetja: Numri i anëtarëve të familjes që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
1A	33	1A	19	1A	21	1A	16
2A	17	2A	31	2A	25	2A	22
3A		3A		3A	4	3A	10
4A		4A		4A		4A	2
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 5.120c		Chi-Square 2.880c		Chi-Square 14.920a		Chi-Square 17.520c	
Df 1		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .024		Asymp. Sig. .090		Asymp. Sig. .001		Asymp. Sig. .001	

Grafikoni 4.




Në tabelën 5 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen Numri i anëtarëve të familjes që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre nuk kanë anjë anëtar të punësuar jashta vendit (N=38); Sig. <000, te nxënëset nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre nuk kanë një anëtar të punësuar jashta vendit (N=47); Sig. <000; te nxënësit nga fshati vërehet se prej tyre që kanë një anëtar të punësuar jashta vendit (N=4); Sig. <000 dhe te nxënësit nga fshati që kanë dy anëtar të punësuar jashta vendit (N=17); Sig. <000.

Tabela 5. Pyetja: Numri i anëtarëve të familjes që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
Asnjë	38	Asnjë	47	Asnjë	38	Asnjë	29
Një	12	Një	3	Një	1	Një	4
Dy		Dy		Dy	11	Dy	17
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 13.520c		Chi-Square 38.720c		Chi-Square 43.960a		Chi-Square 18.760a	
Df 1		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000	

Grafikoni 5.




Në tabelën 6 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen Sa anëtarë të familjes janë studentë? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre kanë dy student (N=21); Sig. >206, te nxënëset nga qyteti vërehet se prej tyre kanë dy student (N=21); Sig. <000; te nxënësit nga fshati vërehet se prej tyre prej tyre kanë një student (N=20); Sig. <044 dhe te nxënësit nga fshati që nuk kanë asnjë student (N=15); Sig. >641.

**Tabela 6. Pyetja: sa anëtarë të familjes janë student?
Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat**

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
Asnjë	11	Asnjë	18	Asnjë	13	Asnjë	15
Një	18	Një	5	Një	20	Një	12
Dy	21	Dy	21	Dy	11	Dy	14
Tre		Tre	6	Tre	6	Tre	9
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 3.160a		Chi-Square 16.080d		Chi-Square 8.080c		Chi-Square 1.680d	
Df 2		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .206		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .044		Asymp. Sig. .641	

Grafikoni 6.




Në tabelën 7 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen Të ardhurat financiare mujore në familje? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se te shumica prej tyre kanë të hyra financiare mbi 400.00E (N=21); Sig. <.000, te nxënëset nga qyteti vërehet se kanë të hyra financiare mbi 400.00E (N=22); Sig. <.000; te nxënësit nga fshati vërehet se kanë të hyra financiare mbi 4000 (N=16); Sig. <.000 dhe te nxënësit nga fshati që nuk kanë të hyra financiare mbi 400.00E (N=21); Sig. <.000.

Tabela 7. Pyetja: Të ardhurat financiare në familje? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatra

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
250.00>	8	250.00>	10	250.00>	4	250.00>	8
400.00>	21	400.00>	22	400.00>	16	400.00>	21
500.00>	10	500.00>	11	500.00>	14	500.00>	0
700.00>	2	700.00>	4	700.00>	4	700.00>	0
900.00>	2	900.00>	0	900.00>	0	900.00>	0
2800.00>	1	2800.00>	0	2800.00>	0	2800.00>	17
3000.00>	1	3000.00>	2	3000.00>	11	3000.00>	3
4500.00>	5	4500.00>	1	4500.00>	1	4500.00>	1
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 52.400d		Chi-Square 37.120e		Chi-Square 22.720d		Chi-Square 30.400d	
Df 7		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .000	

Grafikoni 7.




Në tabelën 8 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen, Frekuentoni qendrat rekreative sportive-fitnesset? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se shumica prej tyre frekuentorijë 1-2herë (N=20); Sig. >.571, te nxënëset nga qyteti vërehet se shumica prej tyre frekuentorijë >3herë (N=29); Sig. <.000; te nxënësit nga fshati vërehet se shumica prej tyre frekuentorijë 1-2herë (N=28); Sig. <.001 dhe te nxënësit nga fshati që shumica prej tyre nuk frekuentojnë asnjëherë (N=29); Sig. <.001.

Tabela 8. Pyetja: Frekuentoni qendrat rekreative sportive-fitnesset? Përgjigja e meshkujve dhe femrave nga qyteti dhe fshatrat

P1QM	N	P1QF	N	P1FM	N	P1FF	N
Jo	16	Jo	8	Jo	14	Jo	29
1-2 herë	20	1-2 herë	13	1-2 herë	29	1-2 herë	14
3>herë	14	3>herë	29	3>herë	7	3>herë	7
Total	50	Total	50	Total	50	Total	50
Chi-Square 1.120a		Chi-Square 14.440a		Chi-Square 15.160a		Chi-Square 15.160a	
Df 2		Df 2		Df 2		Df 2	
Asymp. Sig. .571		Asymp. Sig. .000		Asymp. Sig. .001		Asymp. Sig. .001	

Grafikoni 8.




Në tabelën 9 janë të paraqitur përgjigjet në pyetjen, Mereni me sport aktivisht? te meshkujt nga qyteti (P1QM), femrat nga qyteti (P1FQ), meshkujve nga fshati (P1FM), femrat nga fshati (P1FF). Rezultatet nga përgjigjet e nxënësve nga qyteti vërehet se shumica prej tyre nuk merren me sport aktivisht (N=20); Sig. >.571, te nxënëset nga qyteti vërehet se shumica prej nuk merren me sport aktivisht (N=38); Sig. <.000, te nxënësit nga fshati vërehet se shumica prej tyre nuk merren me sport aktivisht (N=37); Sig. <.001 dhe te nxënësit nga fshati që shumica prej tyre nuk merren me sport aktivisht (N=47); Sig. <.001.

